



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



DREJTORIA E ARSIMIT

Nr.05-04

Data:06.01.2020

PODUJEVË

Në bazë të nenit 8 të Ligjit Nr.03/L -212 të Punës, Drejtoria e Arsimit në Komunën e Podujevës shpall këtë:

KONKURS

Pozita e punës: Kuzhinier/e

Institucioni edukativo-arsimor: IP "Armela", Podujevë

Orari i punës: 40 orë në javë

Paga: 272.88 €

Kohëzgjatja e kontratës: 1 vit me mundësi të vazhimit

Detyrat dhe Përgjegjësitë :

- Përkujdeset për përgatitjen e ushqimit në kuzhinën qendrore;
- Kujdeset që kuzhina dhe të gjitha pajisjet e kuzhinës, gjatë përgatitjes dhe shërbimit të ushqimit, të përdoren në mënyrë korrekte dhe të jenë në gjendje funksionale dhe të gatshme për përdorim;
- Kujdeset dhe siguron që zonat e gatimit të ushqimit në kuzhinë të jenë në gjendje të pastër, enët e kuzhinës, ushqimi, pemët dhe perimet të pastrohen mirë;
- Kujdeset që të përdoren metodat e duhura të gatimit të ushqimit, duke siguruar që proteinat dhe vitaminat e ushqimit të mos humbin për shkak të zierjes së gjatë;
- Numërimi i shujtave dhe klasifikimi i tyre në bazë të numrit të fëmijëve;
- Koordinimi i punës me kryekuzhinierin/en;
- Gatishmëri për bashkëpunim me stafin e kuzhinës qendrore;
- Të respektoj orarin e punës dhe hierarkinë/menaxhmentin
- Të kryejë edhe detyra të tjera të caktuara nga rregullorja e institucionit apo udhëheqësi;

KUSHTET:

- Përgatitje profesionale në fushën e kulinarisë;
- Përvojë pune në kuzhina me kapacitet të lartë të përgatitjes;
- Përvojë në përgatitje të produkteve me receta të ndryshme;

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

Formulari i aplikimit; (i cili merret dhe dorëzohet në qendrën për shërbime të qytetarëve);
në objektin e ri të Komunës, rr. " Nuhi Gashi " Podujevë.
Kopja e letërnjoftimit;
Dëshmitë për përvojën e punës në lëmin përkatës;
Dëshmitë për kualifikimin në lëmin përkatës;
Certifikatën që nuk jeni në hetime (jo më më të vjetër se 6(gjashtë)muaj.

Afati i konkursit

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, në tabelën e shpalljeve në objektin e komunës dhe në ueb-faqen e Komunës së Podujevës:
<http://kk.rks-gov.net/podujeve>, pra deri më datë 21.01.2020.

Drejtori i DKA-së

Agim Blakçori

